



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



# KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

*Raporti vjetor i punës për vitin 2015*

*drejtuar*

*Kuvendit të Republikës së Kosovës*

*Mars 2016*

## Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	7
KORNIZA LIGJORE .....	9
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT .....	9
Misioni i KPM-së është: .....	9
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	9
Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së.....	9
Përbërja e KPM-së .....	10
AKTIVITETET E KPM-së.....	10
Fillimi i zbatueshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore.....	11
Komisioni Mbikëqyrës.....	11
Hartimi i akteve nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve mediale audio-vizuale..	12
LICENCIMI I SHTATË (7) KANDIDATËVE PËR TË OFRUAR SHËRBIME MEDIALE AUDIO NË SHTATË (7) KOMUNA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	12
TAKIMET ME TË LICENCUARIT TË CILËT NUK E KANË PAGUAR TAKSËN VJETORE PËR LICENCË PËR VITIN 2015 .....	13
Transmetimet ilegale.....	13
Raportimi i KPM-së në takimin e dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit .....	14
Implementimi i Projektit “Sistemi digjital” .....	14
NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIO-VIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	15
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE .....	15
Bashkëpunimi me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS), shoqatat për menaxhimin kolektiv të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën audio- vizuale dhe atë të muzikës APIK dhe VAPIK.....	15
Bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë .....	16
Bashkëpunimi me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët .....	16

Takimet e KPM me përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese .....	16
<b>BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT QË VEPROJNË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS</b> .....	17
Angazhimi i ekspertit për dhënien e asistencës KPM-së në krijimin e infrastrukturës ligjore për procesin e digjitalizimit .....	17
Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe United Nations Children’s Fund in Kosovo (UNICEF) .....	18
Bashkëpunimi me Fondacionin Thompson .....	18
Pjesëmarrja e KPM-së në konferencat e EPRA-së (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullative) .....	19
<b>PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE</b> .....	21
Burimet njerëzore.....	21
<b>DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)</b> .....	22
Monitorimi i zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Gracanicës .....	22
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuale.....	23
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren 2013/03 për Komunikime Komerciale Audio-vizuale.....	23
Monitorimi i Pajtushmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit .....	24
Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë.....	24
Rregullorja për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC - 2007/04 .....	25
Pajtushmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuale.....	25
Rastet e ngritura lidhur me Kodin e Sjelljes: .....	25
Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3 .....	25
Vizitat/ Inspektimet në terren.....	26
<b>DEPARTAMENTI I LICENCIMIT</b> .....	26
Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës.....	26
Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:.....	27
Numri Operatorëve Kabllorë të licencuar:.....	27
Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP).....	27

Shqyrtimi i kërkesave .....	28
Në përgjithësi, gjatë vitit 2015 janë marrë këto vendime për licencim: .....	28
Rastet të cilat janë bartur tek Departamenti Ligjor dhe rastet që janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisioni, gjithsejtë janë 11:.....	28
Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2016, janë gjithsej 5 raste: .....	29
Bashkimi i kërkesave .....	29
Licencimi i radio stacioneve të reja sipas konkursit për frekuenca të lira .....	29
<b>DEPARTAMENTI LIGJOR.....</b>	<b>30</b>
Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28-Mos sjellja e raportit vjetor .....	30
Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KPM - 2013/03 .....	30
Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01.....	31
Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02 .....	31
Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës .....	31
Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë .....	32
Rastet për shkeljen e Rregullores për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04 .....	32
Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2015, Shkelja e Kodit të Sjelles për Shërbimet Mediale Audi vizuale KKPM – 2010/01, dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithëshme të Licencës.....	32
<b>DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR .....</b>	<b>35</b>
Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge.....	35
Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....	35
Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini) .....	36
Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal .....	37
Rastet për interferencë .....	37
Rastet për transmetime të palicencuara.....	38
Frekuencat e revokuara nga KPM.....	38
Subjektet transmetuese që kanë ndërprerë transmetimin.....	38

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR. ....	38
Kërkesa për ndryshimin të lokacionit të transmetimit .....	38
Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së.....	39
Ndryshime në Frekuencë, Fuqie të transmetimit te subjektet transmetuese:.....	39
Ngritja e kapaciteteve .....	39
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE.....	40
Buxheti .....	40
PUNA E BORDIT PËR ANKESA (BA).....	44
Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa .....	44
Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2015 janë si në vijim: .....	44
OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2015: .....	45
OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2016: .....	46
Rekomandimet/sfidat e institucionit (problemet me buxhetin, rritja e stafit, ndryshimi i ligjit).....	46
Problemet me buxhetin .....	46
Nevoja për punëtorë të rinj .....	46
PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHMENTIT .....	47
Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it .....	49

## Shtojcat

Shtojca I      Organogrami

Shtojca II     Paraqitja tabelare e rasteve ligjore

Shtojca IIIa   Raporti vjetor financiar

Shtojca IIIb   Raporti vjetor financiar

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave ju përcjellim raportin e aktiviteteve të Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2015.

Raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësi të KPM-së.

Raporti i punës së KPM për vitin 2015 përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi/miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuele të licencuara në KPM, me ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, statistikave e numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraparak.

Gjatë vitit 2015, KPM-ja ka monitoruar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me të gjitha rregulloret e Komisionit të Pavarur të Mediave, në veçanti ka vlerësuar pajtueshmërinë e me Ligjin për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës për zbatimin e kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme. Një ndër sfidat e KPM që duhet cekur për vitin 2015, ka qenë mospagesa e taksës së licencës nga një numër i konsiderueshëm i medieve. KPM ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë ligjore që të gjejë një zgjidhje për këtë problematikë, por mbeten prapë edhe disa media që nuk e kanë paguar taksën e vitit 2015. Ndër të gjitha këto që u cekën më lartë, problemi kryesor mbetet buxheti i pamjaftueshëm, si pasojë e shkurtimeve buxhetore dhe pamundësia për të pasur numër të mjaftueshëm të stafit, karshi numrit të madh të të licencuarve dhe obligimeve e detyrave të reja që do të dalin nga të licencuarit e rinj në epokën digjitale, përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore të institucionit

Prioritet parësor i KPM-së për vitin 2016, është implementimi i Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës, krijimi i bazës ligjore sekondare për zbatueshmërinë e Strategjisë si dhe ndërtimi i rrjetit për transmetim televiziv tokësor digjital SFN- allotmenti Kosova.

Objektivat e KPM-së për vitin e ardhshëm mbeten implemtenimi i procesit të digjitalizimit sipas Ligjit për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio Difuzive Tokësore dhe Strategjisë së KPM për Kalim në Transmetim Digjital Tokësor, të cilën Strategji KPM e ka dorëzuar në Qeveri me 31 mars 2015 dhe pret miratimin nga Qeveria e Republikës së Kosovës, zhvillimi i pluralizmit

medial që u shërben gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i digjitalizimit, në harmoni me rregullativen evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit.

**Mars 2016**

## **KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE**



## KORNIZA LIGJORE

KPM është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe i themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Në bazë të nenit 3 paragrafi 2.8 KPM-ja “*i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.

## PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

### *Misioni i KPM-së është:*

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele

## ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

### *Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së*

Sipas Ligjit të Nr. 04/L-44, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11 pika 2.1. të Ligjit për KPM, i cili përcakton: “brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

### *Përbërja e KPM-së*

<b>Emri</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>	<b>i/e emëruar</b>	<b>Kohëzgjatja e mandatit</b>
Adnan	MEROVCI	Kryetar	më 19 mars 2014	mandat 4 (katër) vjeçar
Driton	QERIQI	Nënkryetar	më 19 mars 2014	mandat 3 (tre) vjeçar
Anita	MORINA-SARAÇI	Anëtare	më 19 mars 2014	mandat 2 (dy) vjeçar
Abit	HOXHA	Anëtar	më 14 prill 2014	mandat 2 (dy) vjeçar
Xhemajl	KRASNIQI	Anëtar	më 30 gusht 2012	mandat 4 (katër) vjeçar
Jelena	SIMIQ	Anëtare	më 12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar
Mejdin	SALIJI	Anëtar	më 12 mars 2015	mandat 3 (tre) vjeçar

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafi 2, i Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

## **AKTIVITETET E KPM-së**

Gjatë kësaj periudhe kohore për të cilën raportohet, në bazë të obligimeve ligjore, KPM-ja ka mbajtur dhjetë (10) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit të KPM-së të cilat janë të paraqitura në këtë raport.

## ***Fillimi i zbatueshmërisë së Ligjit Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore***

Më 31 mars 2015, Komisioni i Pavarur i Mediave ka dërguar për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës Strategjinë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës.

Më 24 gusht 2015 është publikuar në Gazetën Zyrtare Ligji Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore, i shpallur me dekretin Nr. DL-025-2015, datë 17.08.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga. Ligji ka hyrë në fuqi (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ky ligj ka paraparë edhe nxjerrjen e disa akteve nënligjore nga KPM për çfarë KPM ka krijuar dinamikën e punës dhe një sërë aktiviteteve për zbatimin e këtij ligji.

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore, përkatësisht nenin 5 të Shtojcës *Rregullat për përmbajtjen dhe procedurën për tenderë publik për kanalet 46 dhe 58*, është themeluar Komisioni Mbikëqyrës prej 6 anëtarësh, në këtë përbërje: tre (3) anëtarë prej KPM-së, dy (2) prej ARKEP dhe një (1) prej MZHE-së. Ky Komision kryesohet nga Kryetari i KPM-së, z. Adnan MEROVCI.

Ky Komision sipas ligjit ka për obligim që ta mbikëqyrë procedurën e tenderit publik, të sigurojë transparencë të plotë të procesit tenderues dhe të sigurojë një bashkërendim të ngushtë mes autoriteteve publike. Lidhur me këtë, përmes një shkrese, KPM ka kërkuar nga Ministri për Zhvillim Ekonomik dhe nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare që sipas ligjit në fjalë të bëjnë emërimet e përfaqësuesve të tyre në mënyrë që Komisioni Mbikëqyrës të funksionalizohet.

Gjithashtu duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore, KPM ka miratuar edhe Planit Frekuencor për Transmetimet Tokësore Digjitale.

### ***Komisioni Mbikëqyrës***

Me iniciativën e KPM-së, më 10 dhjetor 2015, është mbajtur takimi konstituiv i Komisionit Mbikëqyrës, i cili në bazë të nenit 5 të Shtojcës së Ligjit Nr. 05/L-027 për Digjitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore, ka për obligim që ta mbikëqyrë procedurën e tenderit publik, të sigurojë transparencë të plotë të procesit tenderues dhe të sigurojë një bashkërendim të ngushtë mes autoriteteve publike.

Ky Komision sipas Ligjit për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio-difuzive Tokësore përbëhet prej gjashtë anëtarëve, tre anëtarë nga Komisioni i Pavarur i Mediave, dy anëtarë nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), dhe një anëtar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Ky Komision kryesohet nga KPM, Kryetar i KPM-së, z. Adnan MEROVCI.

### *Hartimi i akteve nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimeve mediale audio-vizuale*

KPM ka krijuar grupin punues për amandamentimin e Rregullores CIMC–2007/04 së Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, i cili ka punuar lidhur me përcaktimet e rregullave dhe procedurave që janë bërë në Draftin e Rregullores për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audio-Vizuale. Në këtë proces KPM ka përfshirë edhe palët e interesit me të cilët ka organizuar takime konsultative për të shqyrtuar dhe diskutuar çështjet kyçe të kësaj rregulloreje.

## **LICENCIMI I SHTATË (7) KANDIDATËVE PËR TË OFRUAR SHËRBIME MEDIALE AUDIO NË SHTATË (7) KOMUNA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, më 26 dhjetor 2014, KPM ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim të programeve në radio, për 8 Komuna në Republikën e Kosovës. Konkursi publik ka qenë i hapur (30 ditë) deri më 26 janar 2015.

KPM në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2015, ka marrë vendim për licencimin e shtatë (7) kandidateve të cilët kanë plotësuar kriteret për transmetim të radio programeve në shtatë (7) komuna të Republikës së Kosovës:

- RADIO 7” - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Junikut
- RADIO 38 - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Graçanicës
- RADIO BRAVO - me mbulim që i përket kategorisë me fuqi të ulët, Komuna e Istogut
- RADIO MARIA - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Obiliqit
- RADIO KM - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Mitrovicës
- RADIO KENT FM - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Mamushës
- RADIO CAMPUS - me mbulim që i përket kategorisë lokale, Komuna e Lipjanit

## **TAKIMET ME TË LICENCUARIT TË CILËT NUK E KANË PAGUAR TAKSËN VJETORE PËR LICENCË PËR VITIN 2015**

Komisioni i Pavarur i Media (KPM) ka organizuar disa takime radhazi me përfaqësuesit e shërbimeve mediale audio-vizuale të cilët nuk e kanë kryer obligimin ligjor të pagesës së taksës së licencës për vitin 2015, obligim ky që del nga Rregullorja e KPM-2014/03 për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë.. KPM ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore dhe të gjitha mundësitë tjera të komunikimit për të gjetur një zgjidhje duke u dhënë disa herë afate shtesë për pagesën e taksës, i fundit i vendosur me 31 dhjetor 2015, por fatkeqësisht vetëm një numër i vogël i të licencuarve e kanë kryer këtë obligim ligjor ndaj KPM.

Qëllimi i takimeve ishte diskutimi i hapur me përfaqësuesit e shërbimeve mediale audio-vizuale për këtë çështje si dhe gjetja e mundësive për të kryer obligimet ligjore sipas Ligjit Nr. 04/L-44, respektivisht Rregullores KPM-2014/03, në mënyrë që të evitohet ndërmarrja e masave ligjore nga ana e KPM-së. KPM në të gjitha këto takime ka sqaruar se është mjaft shqetësuese që një numër i konsiderueshëm (48 ofrues të shërbimeve audio-vizuale) nuk kanë arritur të kryejnë obligimet ligjore, përfshirë këtu edhe transmetuesin publik RTK, për të cilin KPM ka qasje më specifike, për arsye të statusit që ka RTK-ja sipas ligjit.

Përfaqësuesit e shërbimeve mediale audio-vizuale, ata të cilët kanë qënë të pranishëm në takime, janë arsyetuar me gjendjen e tyre jo të mirë në planin e qëndrueshmërisë financiare dhe problemin e pranisë së mediave ilegale të cilat paraqiten në forma të ndryshme në internet, gjë që sipas tyre u krijon probleme gjatë komunikimit me qytetarët si dhe bashkëpunimit me bizneset në rajonet ku operojnë. Kërkesë e tyre ishte mundësimi i pagesës së taksës në dy këste, njëra të paguhej në gjysmën e vitit dhe tjetra në fund të vitit si dhe të bëhet kategorizimi i medieve sipas specifikave dhe mbulueshmërisë së tyre. KPM ua ka mundësuar edhe këtë kërkesë dhe pse me shumë vështirësi për shkak të pagesave në sistem, por vetëm një numër i vogël e kanë kryer pagesën. Përfundimisht kjo çështje është bartur për vitin 2016, ku KPM do të jetë e detyruar ta zbatojë ligjin, që nënkupton revokimin e licencave, nëse shërbimeve mediale audio-vizuale nuk kryejnë obligimin ligjor të pagesës së taksës.

### ***Transmetimet ilegale***

Gjatë monitorimit të vazhdueshëm që KPM i bënë spektrit të transmetimit në vend, ka vërejtur se në disa raste po bëhen operime ilegale nga operatorë kabllorë. Këtë çështje KPM e ka diskutuar

në mbledhjen e mbajtur me 17 shtator 2015, ku e bënë të qartë se do të ndërmerr të gjitha masat adekuate deri në konfiskimin e pajisjeve transmetuese për ndalimin e kësaj veprimtarie.

### ***Raportimi i KPM-së në takimin e dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit***

Në kuadër të takimit të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për “Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëri Informativë” të mbajtur në 10 mars, 2015 me Komisionin Evropian në Bruksel, përfaqësues të KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurisë së punës në strategjinë për digjitalizim, harmonizimin e akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMS), punën në ndryshimin e rregullores për operatorët kabllorë dhe problemet me të cilat po ballafaqohet KPM për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore. Theks i veçantë është vënë në pamundësinë e fuqizimit të kapaciteteve për realizimin e objektivave institucionale që lidhen me zbatimin e strategjisë për digjitalizim, në kuadër të të cilave duhet hartuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore si dhe duhet realizuar informimi publik me qëllim të sigurimit të një procesi sa më të lehtë dhe më të pranueshëm për publikun lidhur me kalimin në transmetim digjital. KPM për të gjitha këto veprime ka zero buxhet.

### ***Implementimi i Projektit “Sistemi digjital”***

Zyrtarët nga Departamenti i Menaxhimit Frekuencor kanë ndjekur dy trajnime, një në Paris/Francë për punën me softuerët ICS Manager, ICS telekom dhe Antios, programe software të ATDI për planifikim frekuencor digjital dhe trajnimin tjetër në Rohde & Schwarz në Vjenë/Austri lidhur me instrumentet matëse nga fusha e teknologjisë televizive digjitale, veprime këto në kuadër të vazhdimin të Implementimit të Projektit “Sistemi digjital” - projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës, me qëllim për avancimin e pajisjeve softuerike dhe hardverike të KPM-së për planifikim dhe implementim të sistemit digjital në Kosovë.

Me realizimin e tërësishëm të këtij projekti që po vazhdon implementimi, do të mundësohet të bëhen përgatitjet e duhura rreth procesit të zhvillimit të dialogut për zbatimin e marrëveshjes me Serbinë (për Telekomin në kuadër të së cilës hyn edhe koordinimi i frekuencave digjitale), me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor nga të dy palët në brezet radio difuzive UHF/VHF/TV, bandet III, IV dhe V.

## **NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIO-VIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Me ftesë të udhëheqësit të Autoriteti të Mediave Audio-vizive (AMA) të Republikës së Shqipërisë z. Gentian SALA, një delegacion i KPM i udhëhequr nga Kryetari z. Adnan MEROVCI, më 6 mars 2015 ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë. Me këtë rast KPM dhe AMA kanë nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi. Marrëveshja është nënshkruar nga Kryetari i KPM-së z. Adnan MEROVCI dhe homologu i tij nga AMA z. Gentian SALA.

Përmes kësaj marrëveshje synohet promovimi dhe bashkëpunimi reciprok në fushën e rregullimit audio-viziv. Marrëveshja përmban një seri aktivitete që do t'i koordinojnë në të ardhmen dy autoritetet, si ajo e aspektit teknik që ka të bëjë kryesisht me koordinimin e frekuencave radio-difuzive që duhet të shfrytëzohen, pastaj aspekti programor si dhe këmbimi i përvojave të dyanshme.

Sipas marrëveshjes, një grup i përbashkët do të mbledhet dy herë në vit për të ndjekur zbatimin e saj, ndërkohe që si formë e bashkëpunimit janë parashikuar pjesëmarrja e eksperteve në takime dhe iniciativa në fushën e mediave audio-vizuele.

## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE**

*Bashkëpunimi me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve (MKRS), shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën audio- vizuale dhe atë të muzikës APIK dhe VAPIK.*

Meqë sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, KPM ka një përgjegjësi të përcjelljes së punës së të licencuarve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre karshi obligimeve për sigurimin e marrëveshjeve valide për të drejtat e autorit dhe të drejtat e transmetimit dhe ritransmetimit, është e rëndësishme që të ketë zbatueshmëri sa më të madhe të përcaktimeve ligjore që janë bërë.

Lidhur me këtë, më 18 dhe 19 qershor 2015, KPM ka kontribuar duke qenë nikoqire e organizimit të takimeve të ndara me të licencuarit e KPM-së (Televizione, Ofrues të Shërbimeve

Programore, Radio dhe Operatorë Kabllorë) dhe Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Përfaqësuesit e Shoqatave për Menaxhim Kolektiv të të Drejtave të Autorit, APIK dhe VAPIK.

Në këto takime, shoqatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave të autorit kanë prezantuar punën, obligimet e tyre ligjore si dhe kanë diskutuar për fillimin e negocimit për tarifatat dhe orientimin drejt nënshkrimit të një marrëveshjeje kolektive, përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisë nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuale për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve, siç përcaktohet me Ligjin për Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

### ***Bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë***

KPM ka bashkëpunuar me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ku ka dhënë kontribut në ofrimin e informatave në fushën e rregullimit të shërbyesve medial audio-vizual, të cilat kanë ndihmuar në analizimin e tregjeve dhe mundësive për individë dhe kompani të cilët operojnë në Kosovë. Po ashtu, me këtë bashkëpunim KPM ka kontribuar në përgatitjen e MTI-së për raundin e negociatave në CEFTA për Shërbimet e Komunikimit dhe Ndërtimtarisë, përfshirë përditësimin e bazës së të dhënave TIS.

### ***Bashkëpunimi me Zyrën e Komisionarit për Gjuhët***

Ligjit Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve obligon përdorimin e gjuhëve nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe organizatave e ndërmarrjeve tjera që kryejnë funksione dhe shërbime publike në territorin e Republikës së Kosovës. Një ndër institucionet e cila e zbaton këtë ligj është edhe KPM-ja e cila është vlerësuar gjatë monitorimit dhe analizës së faqes zyrtare që është bërë nga Zyra e Komisionarit për Gjuhët e cila mbikëqyrë zbatimin e Ligjit, me qëllim të ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës, gjuhëve zyrtare të komunave, gjuhëve në përdorim zyrtarë në komuna dhe gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është njëra prej gjuhëve zyrtare.

### ***Takimet e KPM me përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese***

Përfaqësues të Zyrës Ekzekutive të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) kanë marrë pjesë në një takim të përbashkët me përfaqësuesit e Zyrës së Avokatit të Popullit (AP), Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) dhe të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), si institucione të pavarura të themeluara me Kushtetutën e vendit. Takimi u zhvillua me iniciativë të Avokatit të Popullit, z. Hilmi Jashari. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i përbashkët i sfidave dhe vështirësive me të cilat këto institucione po ballafaqohen, qoftë sa u përket mekanizmave funksionalë qoftë mekanizmave ligjorë dhe çështjeve buxhetore.



## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT QË VEPROJNË NË REPUBLIKEN E KOSOVËS**

Në kuadër të bashkëpunimit me OSBE-në Misioni në Kosovë, KPM më 19 mars 2015, ka zhvilluar takim me Shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Jean-CLAUDE SCHLUMBERGER. Në këtë takim KPM ka njoftuar Ambasadori me aktivitetet më të rëndësishme të KPM-së, në përmbushje të obligimeve kushtetuese e ligjore, me theks të veçantë përkushtimin e saj në finalizimin e Strategjisë për kalim nga sistemi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës.

OSBE e ka vlerësuar rëndësinë e KPM-së dhe e ka shprehur përkushtimin e tij për përkrahje të vazhdueshme institucionit, në zbatimin e standardeve më të larta në fushën e rregullimit të shërbimeve mediale audio-vizuele. Nga ky takim u konkludua se vetëm institucionet që janë të qëndrueshme dhe të zhvilluara, mund t'i përmbushin funksionet e tyre në mënyrë efektive. Bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Kosovë në kuadër të realizimit të tryezave për lirinë e medias dhe standardet profesionale.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka organizuar tryeza me temën “Liria e medias dhe standardet profesionale” në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren. Qëllimi i tryezave ka qenë që të vlerësohet gjendja aktuale në lidhje me liritë e medias, si dhe standardet etike dhe profesionale në Kosovë. Po ashtu tryeza ka për qëllim që pjesëmarrësit të japin rekomandime për palët relevante të interesit se si të përmirësohen standardet e medias në Kosovë. KPM ka prezantuar Kodin e Sjelljes si dhe sfidat rregullatore të KPM-së në një ambient ku tashmë janë duke bashkëjetuar mediat tradicionale dhe mediat e reja.

### ***Angazhimi i ekspertit për dhënien e asistencës KPM-së në krijimin e infrastrukturës ligjore për procesin e digjitalizimit***

OSBE misioni në Kosovë për shtatë ditë ka angazhuar një ekspert i cili bashkërisht me stafin e KPM-së kanë analizuar gjendjen aktuale të infrastrukturës ligjore, të gjitha akteve nënligjore, si dhe krijimin e infrastrukturës së re ligjore e cila do të rregullon transmetimet digjitale tokësore në Republikën e Kosovës, në harmoni me legjislacionin e BE-së si dhe në bazë të praktikave më të mira evropiane.

## ***Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe United Nations Children's Fund in Kosovo (UNICEF)***

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, KPM ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF-in. Këtë marrëveshje bashkëpunimi me UNICEF-in, KPM e ka nënshkruar në mënyrë që të promovoj dhe mbrojtë të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovë gjatë prezantimit të tyre në media si edhe karshi ekspozimit të tyre ndaj përmbajtjeve programore që cilësohen të dëmshme. Marrëveshja është nënshkruar më 30 qershor 2015.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit me UNICEF-in më 30 qershor 2015, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në transmetim KPM ka kontribuar në hartimin e raportit të UNICEF që ka bërë lidhur me vlerësimin e kornizës ligjore dhe rregullative në fushën e fëmijëve në Republikën e Kosovës. Ky vlerësim është fokusuar në rishikimin e ligjeve, programeve dhe dokumenteve rregullative në fushën e medias, duke identifikuar dispozitat që kanë të bëjnë me fëmijët, të rinjtë dhe familjen, dhe duke analizuar se si këto dispozita i mbrojnë ata nga raportimi joetik.

Aktivitetet të ngjashme KPM do të vazhdojë edhe në të ardhmen, për të identifikuar mënyrat se si të përforcohet korniza ligjore dhe rregullative, si dhe t'iu ofrohet përfaqësuesve të mediave mbështetje në forcimin e rolit të tyre në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke vepruar si kampionë dhe avokues për të drejtat e fëmijëve.

### ***Bashkëpunimi me Fondacionin Thomson***

Në kuadër të projektit “Media For All” projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, në bashkëpunimit me Fondacionin Thomson KPM ka organizuar dy tryeza: Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Përmbajtja Mediale e Transmetuesve në Kosovë (6 nëntor 2015) si dhe Të drejtat e Autorit në Transmetim (14 dhjetor 2015). Në tryezën e parë e cila është mbajtur me 6 nëntor 2015, është paraqitur puna dhe aktivitetet e KPM-së në monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit nga ana e të licencuarve, si dhe veprimet e ndërmarra nga KPM-ja. Ndërkaq në tryezën e dytë e cila është mbajtur më 14 dhjetor 2015, është paraqitur puna e KPM-së duke potencuar vëmendjen e posaçme që KPM u kushton të drejtave të autorit në transmetim gjë që tregon edhe me numrin e rasteve të trajtuara dhe proceduara, pastaj veprimet e ndërmarra nga KPM-ja si dhe obligimet që dalin nga Ligji Nr. 04/I-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe nga Rregullorja KPM 2013\_02 për të Drejtën e Autorit. Është me rëndësi të theksohet pjesëmarrja e znj. Jadranka VOJVODIĆ, Zëvendës Drejtoreshë në Agjencinë për Mediat Elektronike në Mali të Zi e cila ka paraqitur praktikat e rregullimit të të drejtave të Autorit në transmetuesit Evropian. Konkluzion i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte se Ligji për të Drejtat e Autorit, i cili aktualisht është në proces të amendamentimit, duhet të procedohet dhe miratohet sa më shpejtë, dhe më pas të vijohet me harmonizimin e akteve të nevojshme nënligjore si dhe të funksionalizohet i gjithë sistemi, i cili do të siguronte respektimin

e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta në përgjithësi dhe të drejtat në shërbimet mediale audio-vizuale në veçanti.

Po ashtu, më 3-4 shkurt 2015 është mbajtur një trajnim me stafin e Zyrës Ekzekutive lidhur me “Edukimin Efektiv të Publikut gjatë kalimit në transmetim televiziv digjital (Effective Public Education in Digital TV Switch-over), në të cilën janë prezantuar praktikat ndërkombëtare për implementim të kampanjave informuese lidhur me procesin e digjitalizimit.

Fondacionin Thomson ka realizuar një reklame me qëllim të promovimit të KPM-së dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës tek publiku në përgjithësi (transmetuar në maj 2015) si dhe realizimin e një reklame me qëllim të informimit të publikut lidhur me procesin e kalimit në transmetim digjital (transmetimi i së cilës ka filluar në shkurt të vitit 2016).

Ndërsa, në maj të vitit 2015, është organizuar një vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë këtij aktiviteti përfaqësues të KPM-së, së bashku me përfaqësuesit e Këshillit për Mediat e Shkruara (KMSHK) dhe dy përfaqësues të medieve (KTV dhe Gazeta Zëri) si edhe përfaqësuesin e Fondacionit Thompson, kanë vizituar rregullatorin për komunikim (OFCOM), vetë-rregullatorin për mediat e shkruara (IPSO), shtëpitë mediale “BBC” dhe “The Guardian” si edhe kanë pasur takime më udhëheqës të Fondacionit Thompson.

Në takimin me përfaqësuesit e rregullatorit homolog për komunikim të Britanisë së Madhe OFCOM, është diskutuar për çështje të ndryshme sa i përket kompetencave të rregullatorëve. Duke qenë se Kosova është në proces të krijimit të infrastrukturës ligjore për procesin e digjitalizimit, në OFCOM theksi është vënë më shumë në diskutimet lidhur me veprimet ligjore dhe rregullatore të OFCOM për procesin e kalimit në transmetim digjital si edhe hartimin e implementimin e akteve nënligjore sekondare.

### ***Pjesëmarrja e KPM-së në konferencat e EPRA-së (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullative)***

Konferenca e EPRA-s është mbajtur më datat 13 deri më 15 maj 2015. KPM është anëtare e EPRA-s që nga viti 2003. Natyra e konferencës së EPRA-së është e karakterit të shkëmbimit të përvojave në fushën e rregullimit të mediave, në mes të anëtarëve të kësaj organizate, sfidave me të cilat përballen në këtë fushë, si dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e këtyre sfidave bazuar në përvojat e ndryshme. Ky takim ishte i 41-ti me radhë i takimeve të rregullta të EPRA-së ( të cilat organizohen dy herë në vit), nikoqir i së cilës kësaj radhe ishte rregullatori i mediave i shtetit Zvicëran, Federal Office of Communications (OFCOM). Pjesëmarrës të kësaj konference dy ditore ishin përfaqësuesit e rregullatorëve nga më shumë se 50 vende, anëtare të EPRA-së, përfaqësuesit e institucioneve relevante evropiane , përfaqësues të instituteve dhe

organizatave të ndryshme të cilët merren me fushën e mediave, në mesin e tyre edhe përfaqësuesit e KPM. Përfaqësuesit e KPM-së ishin pjesëmarrës në zhvillimin e punimeve të dy sesioneve plenare të konferencës, në tri grupet punuese si dhe në pjesën e zgjedhjes së Kryetarit dhe Anëtarëve të Bordit të EPRA-së.

Ndërsa nga data 28 deri më 30 nëntor 2015, në Nuremberg të Gjermanisë është mbajtur takimi i 42 i Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të KPM-së.

Në fokus të konferencës ka qenë tema se si të sigurohet një ekosistem i qëndrueshëm për mediat në Evropë që ofrojnë pluralitetin dhe diversitetin e përmbajtjes. Në kuadër të kësaj janë trajtuar edhe tematika të ndërlidhura me qasjet e reja të cilat ndihmojnë financimin e përmbajtjeve programore me interes publik apo mbështetjen e industrisë për prodhimin e përmbajtjeve dhe përfshirjen e rregullatorëve të mediave. Poashtu me theks të vecantë është diskutuar edhe rreth mjeteve të rregullatorëve të cilat do të përdoren për t'iu qasur llojllojshmërisë së burimeve, prodhimit dhe ekspozimit, me një fokus në monitorimin dhe transparencën e pronësisë së mediave dhe analizimin e trendeve konsumuese. Gjatë zhvillimit të konferencës, është punuar edhe në grupe punuese të fokusuar në:

- 1) Përmbajtjen programore të transmetuesit publik në një ambient ku tashmë operojnë multiplatforma (nga bartja e obligueshme deri tek gjetja e obligueshme);
- 2) Vendosjen e produkteve dhe
- 3) Modelet e financimit të TV regjionale dhe lokale.

Konkluzë e konferencës ishte që qëndrueshmëria, gjetshmëria dhe transparenca janë tre koncepte të përsëritura në debatet mes rregullatorëve dhe ekspertëve të jashtëm dhe sfidë kyçe do të mbetet zbatueshmëria në mënyrë efektive e këtyre tri parimeve për reformën e vazhdueshme të kuadrit rregullator audiovizual.

## PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefja Ekzekutive, e cili ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligji Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 Kryeshefja Ekzekutive menaxhon:

- me nëpunësit civilë të KPM-së,
- me financat dhe me burimet tjera të financimit,
- ofron këshilla për politikat e KPM-së,
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive si dhe
- bënë koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë 4 departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (*Shtojca I Organogrami*):

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës,
- Departamenti i Licencimit,
- Departamenti Ligjor
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor)
- Departamenti i Administratës
- Në kuadër të Zyrës vepron edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe Departamenti i Prokurimit.

### *Burimet njerëzore*

Zyra e KPM nga fillimi i vitit 2015 ka të punësuar gjithsej 41 punëtorë, aq sa edhe është e përcaktuar me ndarje buxhetore nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF). Prej tyre 31 janë Shërbyes Civil ndërsa 10 janë anëtar të Komisionit dhe Bordit të KPM- së të emëruar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2015, dy Drejtor të Departamenteve kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre për arsye të punësimit në institucionet tjera ku kushtet dhe të ardhurat personale kanë qenë me të mira.

Bazuar në planifikimin e bërë është paraparë që në vitin 2016 të arrijmë numrin e stafit prej 41 zyrtarëve si dhe bazuar në kërkesat tona është bërë planifikimi i stafit për vitin 2016, 2017 dhe

2018. Për këtë numër KPM-ja ka paraqit kërkesë që nga viti 2011 dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e numrit të punëtorëve.

Që nga viti 2010 deri më tani, numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm prej rreth 200%.

Po ashtu, KPM është në proces të rishikimit të legjislacionit sekondar që parashihet për implementim të kalimit në transmetim digjital, për të cilin proces nevojitet hartimi dhe amandamentimi i një numri të konsiderueshëm të rregulloreve. Pas kalimit në transmetim digjital, po ashtu do të kemi rritje të numrit të të licencuarve. KPM-ja aktualisht është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi kemi ngarkesa në punë të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë për të kryer detyrat sipas pritjeve. Kjo gjendje me mungesë të stafit gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë.

Ndërsa sa i përket nevojave për trajnimeve për arsye të mungesës së mjeteve buxhetore në linjën mallra dhe shërbime gjatë vitit 2015 ka qenë e pamundur realizimi i trajnimeve të parapara për këtë vit për nevojat e stafit të KPM-së.

## **DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZAVE (DMA)**

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave (DMA), gjatë vitit 2015, ka vlerësuar pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me rregulloret e KPM-së si dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, ndërsa gjatë fushatës për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura për kryetar të komunës së Graçanicës, ka vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 në Republikën e Kosovës.

Realizimi i aktiviteteve të poshtëshënuara dhe rekomandimet e këtij Departamenti, pas monitorimeve të bëra ishin bazë mbi të cilat departamentet tjera të KPM-së kanë mbështetur veprimet e mëtutjeshme

### ***Monitorimi i zgjedhjeve lokale për kryetar të Komunës së Graçanicës***

Në mënyrë që të vlerësojë pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuele me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, i cili përcakton dispozitat për Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës, ka bërë monitorimin e mbulimit të Zgjedhjeve Lokale nga ana e shërbimeve mediale audio-vizuele, të mbajtura për kryetar të Komunës së Graçanicës.

Në monitorim janë përfshirë 6 shërbime mediale audio-vizuele, nga të cilat 3 televizione nacionale dhe 3 Ofrues të shërbimeve programore: RTK2, KLAN KOSOVA, TV KIM.

Fokus i monitorimeve ishin edicionet e lajmeve, kronikat zgjedhore, intervistat, debatet dhe spotet politike në kohën e shikueshmërisë më të madhe, nga ora 16:00 deri 24:00.

Gjatë monitorimit janë bërë matjet e hapësirës së dedikuar kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje si dhe mënyra e prezantimit të tyre.

Në bazë të monitorimit është vlerësuar se këto subjekte kanë vepruar në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje.

### ***Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren KPM 2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-vizuele***

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së shërbimeve mediale audio-vizuale me këtë rregullore, janë monitoruar shërbimet mediale audio-vizuele me mbulim nacional, regional e lokal si dhe ofruesit e shërbimeve programore.

Lidhur me këtë rregullore janë realizuar 40 monitorime, ku nga 26 shërbime mediale audio-vizuele 11 kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore.

Shkeljet e neneve 3, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje janë shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë monitorimit dhe kanë të bëjnë me kufizimet dhe obligimet e përgjithshme, të shërbimeve mediale audio-vizuele si kategorizimi i e programeve, koha e transmetimit të tyre si dhe shenjat dhe piktogramet e përcaktuara në rregullore.

### ***Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren 2013/03 për Komunikime Komerciale Audio-vizuale***

Në fokus të monitorimeve për pajtueshmërinë e shërbimeve mediale audio-vizuale me Rregulloren për Komunikime Komerciale Audio-vizuale ishin: sasia e reklamave të transmetuara brenda një ore program, vendosja e produkteve, sponsorimet, teleshoppingu, reklamimi me ekran të ndarë si dhe dispozita tjera të kësaj rregulloreje.

Lidhur me këtë rregullore janë realizuar 39 monitorime. Nga 24 shërbime mediale audio-vizuele, 13 prej tyre kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore.

Shkeljet e neneve 9.1,10.1, 10.2.3 dhe 13.3 të kësaj rregulloreje të lartë përmendur janë shkeljet më të shpeshta të identifikuara gjatë këtyre monitorimeve, e të cilat kanë të bëjnë me

mos-dallimin e komunikimeve komerciale audio-vizuele nga pjesët tjera programore, kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut, sponsorizimin dhe vendosjen e produkteve.

### ***Monitorimi i Pajtueshmërisë me Rregulloren për të Drejtën e Autorit***

Rregullorja për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta përcakton se të licencuarit duhet të sigurojnë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit, kopjet e të cilave duhet t'i ofrojnë brenda afatit të paraparë në kërkesë të KPM-së.

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, shërbimeve mediale audio-vizuele të monitoruara u janë kërkuar marrëveshjet valide për transmetimin e programeve të caktuara.

Lidhur me këtë rregullore janë realizuar 25 monitorimeve. Kështu nga 22 shërbime mediale audio-vizuele të monitoruara, 9 prej tyre kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore.

Mos-pajtueshmëria me nenin 4 që ka të bëjë me Detyrimet për të Drejtën e Autorit, përkatësisht transmetimin e programeve pa të drejtën e autorit dhe mos-ofrimi i marrëveshjeve për të drejtën e autorit për programet e transmetuara pas kërkesës së KPM-së, kanë qenë shkeljet e gjetura në bazë të monitorimeve të bëra.

Po ashtu, KPM ka pranuar dy ankesa lidhur me këtë rregullore, për të cilat janë realizuar 2 monitorime. Në bazë të monitorimit, dy shërbime mediale audio-vizuele janë gjetur në shkelje për shkak të transmetimit të materialit të pjesshëm pa siguruar një kontratë të vlefshme me pronarin e të drejtave të autorit dhe duke tejkaluar kuotën prej 90 sekondave të paraparë për transmetim të informacioneve të shkurtra në këtë rregullore.

### ***Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë***

Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, janë realizuar 47 monitorime në terren, ex-officio dhe në bazë të ankesave. Nga 20 operatorë kabllor të përfshirë në këto monitorime, 16 prej tyre kanë vepruar në kundërshtim me rregulloren në fjalë.

Mos-pajtueshmëria me nenin 2.1.3 që ka të bëjë me Detyrimet për të Drejtën e Autorit dhe nenin 3.2.1 që ka të bëjë me kanalën e veçantë përmes së cilit identifikohet dhe njëkohësisht ofrohen informacione për parapaguesit, kanë qenë shkeljet e gjetura në bazë të monitorimeve të kryera.



### ***Rregullorja për Distribuimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC - 2007/04***

Lidhur me këtë Rregullore, janë realizuar 19 monitorime, ex-officio dhe në bazë të ankesave. Nga 18 operatorë kabllor të monitoruar, 16 janë gjetur në shkelje të nenit 18.3 dhe 18.4.

Këto shkelje kanë të bëjnë me mos-ofrimin e kontratave për të drejtën e autorit për kanalet e listave të tyre programore.

### ***Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele***

Pajtueshmëria me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele është vlerësuar kryesisht me rastin e ankesave nga publiku ose rasteve ex-officio për shkelje të Kodit të Sjelljes, të ngritura nga KPM.

Lidhur me Kodin e Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio-vizuele janë bërë 12 monitorime, 11 në bazë të ankesave dhe 1 ex-officio.

DMA ka bërë monitorime të detajuara dhe analiza lidhur me ankesat e pranuar për përmbajtje të caktuar programore.

Nga monitorimi i 5 shërbimeve mediale audio-vizuele, 4 prej tyre kanë vepruar në kundërshtim me Kodin e Sjelljes. Shumica e shërbimeve mediale audio-vizuele, pas shkresave të KPM-së, kanë transmetuar reagimet/demantet e palëve ankuese.

### ***Rastet e ngritura lidhur me Kodin e Sjelljes:***

Lidhur me Kodin e Sjelljes, janë parashtruar 12 ankesa. Pas rishikimit të ankesave dhe monitorimit të programeve për të cilat janë parashtruar këto ankesa, janë hartuar raportet të cilat janë përcjellur tek Departamenti Ligjor për veprime të mëtejme.

### ***Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së - Pjesa 3***

Departamenti i Monitorimit dhe Analizave ka vërejtur se një shërbim media audio ka bërë ndryshime të theksuara të skemës programore prandaj ka iniciuar monitorimin për të verifikuar nëse ky subjekt është duke vepruar në pajtim me skemën programore të deklaruar në Pjesën 3 të Licencës. Nga monitorimi, është gjetur se ky subjekt ka vepruar në kundërshtim me Pjesën 3 të Licencës.

### *Vizitat/ Inspektimet në terren*

Vizitat tek shërbimet mediale audio vizuale janë dëshmuar si formë e mirë e bashkëpunimit të KPM-së me to. Mu për këtë qëllim DMA gjatë vitit 2015, ka realizuar vizita tek të gjithë të licencuarit e KPM-së.

Gjatë këtyre vizitave, stafi i KPM-së u njoftua më për së afërmi me punën e shërbimeve mediale audio-vizuale si dhe problemet ose shqetësimet të cilat ato i hasin gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Zyrtarët për monitorim gjatë vizitave kanë verifikuar edhe vendndodhjen e transmetuesve, studiove si dhe nëse shërbimet mediale audio-vizuale mbajnë arkiven 21 ditore të programeve të transmetuara dhe nëse posedojnë të drejtat e autorit për programe të caktuara.

Me qëllim të identifikimit të operatorëve kabllor të cilët veprojnë ilegalisht, zyrtarë të DMA-së kanë bërë vizita e inspektime në tërë territorin e Kosovës. Gjatë vizitave, zyrtarë të DMA-së kanë identifikuar operatorë kabllor ilegal, të cilët janë udhëzuar të ndërpresin operimin ilegal dhe të aplikojnë për licencë të KPM-së.

## **DEPARTAMENTI I LICENCIMIT**

### *Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës*

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për shërbime mediale audio-vizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu që, gjatë vitit 2014 kanë operuar gjithsej 20 TV Stacione, 82 Radio Stacione, 37 Operatorë Kabllorë dhe 58 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit kabllor.

Nga 20 shërbimet mediale televizive me transmetim tokësor të licencuara nga KPM-ja, tre (3) i përkasin kategorisë me mbulim nacional, dhjetë (11) me mbulim regjional dhe shtatë (6) me mbulim lokal. Kategorizimi është i bazuar në vendndodhjen e transmetuesve dhe parametrave teknik

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në fund të vitit 2014 ka ndryshuar Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale (Rregullorja KKPM-2010/02). Ndryshimet e Rregullores në fjalë kanë rezultuar vetëm në përcaktimin e definicioneve rreth kategorive të të licencuarve; përcaktimi i afateve rreth pagesës së tarifës nga të licencuarit si dhe është vendosur që të mos aplikohet kamatë për vonesa në

pagesën e taksës për licencë. Ndërsa, niveli për përcaktimin e shumës së taksës për secilën kategori dhe lloj të licencës mbetet i pandryshuar nga rregullorja paraprake. Që nga data 30 dhjetor 2014 ka hyrë në fuqi Rregullorja për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë (Rregullorja KPM-2014/03) përmes së cilës janë dhënë edhe definicionet e qarta të përcaktimit të kategorizimit të të licencuarve.

### ***Numri i TV dhe Radio stacioneve sipas gjuhëve:***

*Të licencuara 20 TV stacione:*

- *TV stacion publik;*
- *13 TV stacione në gjuhën shqipe;*
- *5 TV stacione në gjuhën serbe;*
- *TV stacion në gjuhën turke.*

*Të licencuara 82 Radio stacione*

- *2 radio stacione publike;*
- *46 radio stacione në gjuhën shqipe;*
- *23 radio stacione në gjuhën serbe;*
- *3 radio stacione në gjuhën boshnjake;*
- *3 radio stacione në gjuhën turke;*
- *2 radio stacione në gjuhën gorane;*
- *1 radio stacion në gjuhën rome;*
- *2 radio stacione multietnike.*

### ***Numri Operatorëve Kabllorë të licencuar:***

*Të licencuar 37 operatorë kabllorë*

- *31 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë shqiptarë;*
- *2 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë goranë;*
- *4 operatorë kabllorë të licencuar me pronarë serbë.*

### ***Ofruesit e Shërbimeve Programore (OSHP)***

*Gjithsej janë të licencuar 57 Ofrues të Shërbimeve Programore (OSHP), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit kabllor.*

- *52 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;*

- 2 OSHP janë të licencuar të transmetojë program në gjuhën Serbe ( OSHP TV Centar dhe TV Kiss)
- 3 OSHP janë të licencuar të transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art)

### ***Shqyrtimi i kërkesave***

Gjatë vitit 2015, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 44 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHP-së, kërkesa për licencë të operatorëve kabllorë, kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, njoftime për heqje dorë nga licenca, ankesa për interferenca, refuzim ndaj kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara si dhe kërkesa që kanë të bëjnë me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

### ***Në përgjithësi, gjatë vitit 2015 janë marrë këto vendime për licencim:***

- 4 vendime për licencimin e OSHP-ve;
- 6 vendime për licencimin e operatorëve kabllorë;
- 2 vendime për ndryshimin e pronësisë (në dy raste me vendime për ndryshim të pronësisë janë ndryshuar edhe emrat e subjekteve sipas kërkesave);
- 4 vendime për ndryshimin e parametrave teknike të licencës;
- 5 vendim për ndërprerje të licencës – Radio (1) OSHP (1) dhe Operatorë Kabllorë (3);
- 3 vendime për ndryshimin e skemës programore;
- 1 vendim për shtyrjen e afatit të pagesës së tarifës vjetore të licencës për subjektet transmetuese që kanë ndryshuar kategorinë si rezultat i ndryshimit të rregullores mbi tarifën e licencës;
- 1 vendim për refuzim të kërkesave si të pa bazuara apo të pa kompletuara.

### ***Rastet të cilat janë bartur tek Departamenti Ligjor dhe rastet që janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisioni, gjithsejtë janë 11:***

- 6 raste të bartura të Departamenti Ligjorë, 4 prej tyre kanë të bëjnë me ndryshimin e lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së, dhe 2 raste kanë të bëjnë me ndërprerjen e transmetimit pa njoftuar KPM-në;
- 5 raste lidhur me ndërhyrjet në frekuencat e transmetimit janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit.

### ***Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2016, janë gjithsej 5 raste:***

- *1 kërkesë për ndryshimin e skemës programore;*
- *1 kërkesë për ndryshimin e pronësisë*
- *1 njoftim për heqje dorë nga licenca;*
- *1 njoftim për ndërprerjen e veprimtarisë të Operatorit kabllorë;*
- *1 njoftim për ndërprerje e transmetimit, pa njoftim paraprak të KPM-së.*

### ***Bashkimi i kërkesave***

*Në dy raste është bërë bashkimi i kërkesave të cilat janë parashtruar nga subjektet të njëjta, për arsye se edhe natyra e kërkesave ka qenë e tillë dhe ka mundësuar një gjë të tillë, që do të thotë se në totalë, nga Departamenti i Licencimit në bashkëpunim me departamentet tjera, gjatë vitit 2015 janë trajtuar 42 raste.*

### ***Licencimi i radio stacioneve të reja sipas konkursit për frekuenca të lira***

Pas përfundimit të konkursit për frekuenca të lira, i cili ka qenë i hapur nga data 26 dhjetor 2014 deri më datën 26 janar 2015, janë themeluar dy komisione: Komisioni i Hapjes së aplikacioneve i cili ka qenë i përbërë nga stafi i Zyrës Ekzekutive dhe Komisioni Vlerësues në kuadër të cilit kanë qenë, përveç stafit të Zyrës Ekzekutive edhe anëtarë të organit vendimmarrës - Komisionit të KPM-së.

Pas hapjes dhe vlerësimit të aplikacioneve është konstatuar se, për të gjitha komunat për të cilat është bërë shpallja për frekuenca të lira të radios ka aplikuar nga një kandidat, me përjashtim të komunës së Lipjanit ku kishte dy kandidatë dhe komunës së Hanit të Elezit që nuk kishte asnjë kandidat.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të aplikacioneve ku secili kandidatë është vlerësuar me pikë në pajtim me rregulloren e KPM-së për Vlerësimin e Aplikacioneve, Departamenti i Licencimit ka përgatitur rekomandimet për secilin rast dhe në bazë të këtyre rekomandimeve Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 25 mars 2015, ka marrë vendim për licencimin e 7 radio stacioneve të reja, ndërsa, më datën 24 prill 2015, ka licencuar shtatë (7) kandidatët fitues.

### ***Tabela me ermin e komunave të Kosovës në të cilat janë licencuar radio stacionet e reja:***

	<b>Komuna</b>	<b>Kategoria e licencës</b>
<b>1.</b>	Junik	Lokale

2.	Mamushë	Lokale
3.	Obiliqi	Lokale
4.	Istog, fshati Osojan	Me fuqi të ultë
5.	Lipjan	Lokale
6.	Graçanicë	Lokale
7.	Mitrovicë	Lokale

## DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar raste të ndryshme të shërbyesve medial audio-vizual për shkelje të dispozitave të Ligjit 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër shërbyesve medial audio-vizual.

Rastet e procedura në bazë të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit të KPM-së, dhe akteve nënligjore të KPM-së, (*Shtojca II Paraqitja Tabelare e Rasteve Ligjore*) janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

### *Rastet e Shkeljes së Ligjit të KPM-së neni 28-Mos sjellja e raportit vjetor*

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015, ka proceduar dyzet e shtatë (47) raste lidhur me këtë shkelje:

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor, pesëmbëdhjetë (15) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri. Rastet janë mbyllur. Ndërsa, për tridhjetë e dy (32) subjekte transmetuese, Komisioni i KPM-së ka marr Vendim masa sanksionuese me Vërejtje.

### *Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-vizuale KPM -2013/03*

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015, ka proceduar dymbëdhjetë (12) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual që janë gjetur në shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audio-Vizuale KPM-2013/03.

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, shtatë (7) nga këto subjektet transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM 2013/03 dhe se rastet janë mbyllur, ndërsa pesë (5) prej tyre bartën për shqyrtim për vitin 2016.

#### ***Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM- 2013/01***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015, ka proceduar nëntë (9) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01.

Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje, tetë (8) nga këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01. Rastet janë mbyllur.

Ndërsa një (1) subjekt transmetues edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, ka vazhduar të veproj në kundërshtim me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01, dhe si rast ligjor bartet për shqyrtim për vitin 2016.

#### ***Rastet për shkelje të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015, ka proceduar dhjete (10) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen e nenit 4, paragrafi 1, dhe 2, “Detyrimet për të Drejtat e Autorit” të Rregullores për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02.

Pas dërgimit të Njoftimeve për Shkelje, dhjetë (10) këto subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM 2013/02, dhe se rastet ligjore janë mbyllur.

#### ***Rastet për shkeljen e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015, ka proceduar tridhjetë e tetë (38) raste kundër shërbyesve medial audio-vizual lidhur me shkeljen Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Pas dërgimit të Shkresë dhe Njoftimit për Shkelje njëzet e tetë (28) subjekte transmetuese kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste ligjore janë mbyllur. Ndërsa gjashtë (6) subjekte tjera edhe pas Njoftimit për Shkelje, kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe për këtë Komisioni i KPM-së, ka marr Vendim ndaj tyre masa sanksionues dënim me gjobë. Rastet janë mbyllur.

Ndërsa katër (4) prej këtyre rasteve bartën për shqyrtim për vitin 2016.

***Rastet për shkeljen e Rregullores për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2014/03 - Mos pagesa e taksës për licencë***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015 ka proceduar pesëdhjetë e shtatë (57) raste lidhur me këtë shkelje. Departamenti Ligjor për të gjitha këto raste ka dërguar Njoftim për Shkelje. Nga 57 subjekte, njëzet e shtatë 27 prej tyre kanë ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2014/03 Ndërsa tridhjetë (30) prej tyre kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2014/03. Këto raste bartën për shqyrtim në vitin 2016.

***Rastet për shkeljen e Rregullores për Distributum Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04***

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2015 ka proceduar gjashtëmbëdhjetë (16) raste lidhur me këtë shkelje:

Pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje nga ana e Departamentit Ligjor për shkelje të nenit 18, paragrafi 3 dhe 4, të gjithë Operatorët Kabllor, kanë ardhur në pajtueshmëri dhe rastet janë mbyllur.

***Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM gjatë vitit 2015, Shkelja e Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audi vizuale KKPM – 2010/01, dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithëshme të Licencës.***

Janë proceduar dymbëdhjetë (12) raste:

- Rasti i parë është proceduar bazuar në ankesën e S.P. të parashtruar ndaj subjektit transmetues KTV për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio-vizuale KKPM-2010/01, ankesa i referohet emisionit “Interaktiv” të transmetuar në KTV, ndaj një kronike të cilën pala ankuese pretendon se është bërë fyerje publike ndaj personalitetit të tij. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KTV, dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio vizuale KKPM-2010/01. Pas analizimit dhe verifikimit të fakteve, KPM ka konstatuar se ankesa ndaj KTV ka qenë e pabazuar. KPM i është përgjigjur me shkresë S.P. për sqarim se ankesa e tyre ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.
- Rasti dytë, është proceduar bazuar në ankesën e z.V. O. në emër të Asociacionit të Arkitekteve të Kosovës të parashtruar kundër OSHP Klan Kosova për shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio-vizuale KKPM-2010/01, ankesa i referohet emisionit “ Ju flet Prishtina” të transmetuar në Klan Kosova ndaj një kronike të cilën pala ankuese e cilëson si tendencioze ndaj Asociacionit të arkitektëve të Kosovës dhe



anëtarësisë së saj. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e Klan Kosova, dhe ka gjetur se Klan Kosova ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio vizuale KKPM-2010/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Klan Kosovës. KPM i është përgjigjur me shkresë përmes postes elektronike Asociacionit të Arkitekteve të Kosovës. Rasti është mbyllur.

- Rasti i tretë është proceduar bazuar në ankesën e Alba Trade Plus, ku në ankesë thuhet se shoqëria Tring TV nuk e ka të drejtën e transmetimit të veprave muzikore, ku pala ankuese pretendon se ka të drejtat ekskluzive të këtyre veprave. KPM ka bërë shqyrtimin e ankesës së Alba Trade Plus dhe për këtë KPM i ka dërguar shkresë lidhur me ankesën e Alba Trade. KPM ka konstatuar se ankesa e tyre ka qenë e pa bazuar. Rasti është mbyllur.
- Rasti i katërt është proceduar bazuar në ankesën e z. H Ll. ndaj KTV, ku në ankesë thuhet se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM-2010/01. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KTV, dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio vizuale KKPM-2010/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së. KPM i është përgjigjur me shkresë përmes postes elektronike z. Ll. Rasti është mbyllur.
- Rasti i pestë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit kabllor IPKO ndaj operatorëve kabllorë që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët kabllorë transmetojnë filma të platformës Tring TV pa të drejta të autorit, ku IPKO pretendon se ka të drejtën ekskluzive të ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. Rasti bartet për vitin 2016.
- Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit kabllor IPKO ndaj operatorit kabllorë EGC, ku në ankesë thuhet se operatori kabllorë EGC ka bërë shkelje të nenit 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e EGC, dhe ka gjetur se EGC ka bërë shkelje të nenit 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje EGC. KPM i është përgjigjur me shkresë IPKO-s Komisioni i KPM-së ka marr Vendim sanksionuese me gjobë në shumë prej 3.000 euro ndaj operatorit kabllor EGC. Rasti është mbyllur.
- Rasti i shtatë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit kabllor IPKO ndaj operatorëve kabllorë që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët kabllorë transmetojnë filma të platformës Tring TV pa të drejta të autorit, ku IPKO

pretendon se ka të drejtën ekskluzive të ritransmetimit për territorin e Republikës së Kosovës. KPM i është përgjigjur me shkresë IPKO-s, Komisioni i KPM-së ka marr Vendim ndaj operatorit kabllor IPKO refuzim i ankesave si të pabazuara. Rasti është mbyllur.

- Rasti i tetë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit kabllor ARTMOTION ndaj operatorit kabllorë J@B-NET që bartin platformën TRING TV, ku në ankesë thuhet se operatorët kabllorë J@B-NET bartë platformën Tring TV pa të drejta të autorit. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e J@B-NET, dhe ka gjetur se J@B-NET nuk bartë platformën e Tring TV pa të drejtën e autorit. KPM i është përgjigjur me shkresë ARTMOTION. Rasti është mbyllur.
- Rasti i nëntë është proceduar bazuar në ankesën e operatorit kabllor KIJTESA NET ndaj operatorëve kabllorë EGC dhe ARDI NET, ku në ankesë thuhet se operatorët kabllorë EGC dhe ARDI NET ka bërë shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e EGC dhe ARDI NET, dhe ka gjetur se EGC dhe ARDI NET nuk kanë bërë shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. KPM i është përgjigjur me shkresë KIJTESA NET. Rasti është mbyllur.
- Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në ankesën e Autoriteti i Mediave audio-vizive të Republikës së Shqipërisë (AMA) ndaj KIJTESA NET për bartjen e platformës SKY DIGITAL pa licencë pasi që licenca e SKY DIGITAL është pezulluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë në Tiranë. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin dhe verifikimin e listës së kanaleve të KIJTESA NET, dhe ka gjetur se KIJTESA NET bartë platformën SKY DIGITAL. KPM i ka dërguar shkresë KIJTESA NET. Rasti është mbyllur.
- Rasti i njëmbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e znj. T. H. asamblistë e Kuvendit Komunal në Istog ndaj KTV, ku në ankesë thuhet se KTV në edicionin qendror të lajmeve ë transmetuar në KTV, ndaj një kronike të cilën pala ankuese pretendon se është bërë fyerje publike ndaj personalitetit të saj. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e KTV, dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audio vizuale KKPM-2010/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së. KPM i është përgjigjur me shkresë përmes postes elektronike znj. H. Rasti është mbyllur.

- Rasti i dymbëdhjetë është proceduar bazuar në ankesën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi kulturore ndaj RTK 1, ku në ankesë thuhet se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale audiovizuale KKPM-2010/01. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e RTK 1, dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio vizuale KKPM-2010/01, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. KPM përmes postes elektronike ka njoftuar KKTK për veprimet e mara ndaj RTK 1. Rasti është mbyllur.

## **DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR**

### *Analiza e Spektrit Frekuencor – Transmetimet analoge*

Gjatë vitit 2015, janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të verifikimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës. Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2011, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

### *Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)*

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV dhe e painterferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimi i rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranuar ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m ) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjeti sekondar, ashtu që të arrihej që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

### ***Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)***

Gjatë vitit 2015 Departamentit për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2014, të cilat kanë pasur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 Mhz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si dhe gjatë vitit paraprak që tregojnë se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa, niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dbuV/m. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivove, Llabjan, Parllövë dhe Bresalc); Kacanik – Hani i Elezit; Mitrovicë – Bajgorë; Shtime – Carralevë, Dragash – Restelicë; Prizren – Brezovicë; Kramovik – Dollc; Pejë – Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka fare pranim të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, KPM konstaton se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini nuk janë duke transmetuar në pajtim me parametrat teknikë siç janë të përcaktuara me pjesën 2 të licencës së KPM-së.

Me gjithë rekomandimin e bërë nga ana e KPM-së, radiove nacionale, që të transmetojnë në pajtim të plotë me parametrat teknikë të përcaktuara në pjesën 2 të licencës së KPM-së me qëllim të ngritjes së cilësisë së sinjalit të transmetimit si dhe shërbimin më cilësor në zonat e përcaktuara me licencë të KPM-së, radiot nacionale nuk janë përgjigjur fare, në lidhje me veprimet që kanë ndërmarrë.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa, në bashkëpunim me ta edhe të gjejmë lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

### *Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regional dhe lokal*

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra vërtetohet se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM radio transmetime) dhe e paiterferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet regionale – lokale mbulojnë rreth **68.14%** të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regionale mbulojnë rreth **96.98%** të territorit të Kosovës.

### *Rastet për interferencë*

Gjatë vitit 2015 DMF, ka pranuar katër ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese radio KiM ( Prishtinë), Radio KM(Mitrovica e Veriut), Radio Sharri (Dragash) dhe Radio Drenasi( Drenas).

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio KIM, rezulton se ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues, nga ana e Radio 038 ( Graçanicë) dhe pas intervenimit, ndërhyrjet janë evituar,

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio KM për interferencë nga një radio stacion i huaj ( B92) nga territori i Serbisë në regjion të Mitrovicës rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues në qendër të Mitrovicë dhe lokacione të tjera të Mitrovicës.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Sharrit për interferencë nga Radio Gora ( Dragash); Radio Zëri i Amerikës, Radio KFOR, Radio Tirana dhe Radio Beograd rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues, por se problemi ka qene në transmetuesin e Radio Sharit.

Raporti i monitorimit lidhur me ankesën e Radio Drenasit për interferencë nga Radio Kosova ( 91,9 MHz), rezulton se nuk ka pasur interferencë në frekuencën e subjektit transmetues përgjatë rrugës së Kombit Drenas-Fushë Kosovë.

### ***Rastet për transmetime të palicencuara***

DMF gjatë vitit 2015 nuk ka proceduar me asnjë rast ilegalë të një radio apo televizioni me frekuencë tokësore në territorin e Republikës së Kosovës.

### ***Frekuencat e revokuara nga KPM***

Pas revokimit të Licencës për Radio Start në frekuencë 94.3 MHz - komuna e Rahovecit nga ana e KPM-së, DMF pas matjeve të bëra konstaton se subjekti transmetues ka ndërprerë transmetimin.

### ***Subjektet transmetuese që kanë ndërprerë transmetimin.***

Gjatë vitit 2015, DMF gjatë matjeve të bëra konstaton se Radio Borzani me frekuencë 97.2 MHz ( Shtërpcë) dhe Radio Kamenica me frekuencë 98.8 MHz ( Kamenicë), kanë ndërprerë transmetimin .

### ***Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.***

DMF gjatë vitit 2015 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Gjate vitit 2015, radiot e huaja ndërkombëtare BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare , nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

Vazhdon bashkëpunimi i KPM-së me KFOR për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

### ***Kërkesa për ndryshimin të lokacionit të transmetimit***

Gjatë vitit 2015 DMF ka proceduar me këto kërkesa të subjekteve transmetuese të licencuara për ndërrim të lokacionit të transmetimit:

-FWF City Radio- kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit (brenda qytetit të Shtërpcës);

-Radio Antena- kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit (brenda Cagllavicës)

- TV Zoom - kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetimit nga Gornje Kushce/Gjilan në pikën e transmetimit Maja e Gjelbër.

### ***Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së***

Gjatë vitit 2015 DMF, ka proceduar me katër raste për ndryshim të vendndodhjes së transmetuesit pa miratim të Komisionit , Radio Drenica (Skenderaj) , Radio Kaçaniku( Kaçanik),Radio Zëri i Pozhoranit ( Pozhoran-Gjilan) dhe Top Kosova Radio ( Prishtinë).

KPM mori vendim që të sanksionoi me gjobë subjektet transmetuese dhe me detyrim të menjëhershëm për kthim të transmetuesve në pikën e licencimit.

DMF,gjatë matjeve të bëra konstaton po ashtu se TV Syri Vizion /Gjakovë vazhdon të transmetoj nga Zatriqi ( pike për transmetim nacional) pa miratim të KPM-së

### ***Ndryshime në Frekuencë, Fuqie të transmetimit te subjektet transmetuese:***

Gjatë vitit 2015 DMF, ka proceduar me një rast për ndryshim të kanalit të transmetimit televiziv nga kanali 43 në kanal 65 për TV Zoom për pikën e transmetimit në Majë të Gjelbër dhe me një kërkesë të Radio Vala Rinore për rritjen e fuqisë së transmetimit nga 700 Ë(ERP) në 3000 Ë(ERP). Komisioni ka marrë vendim për miratimin e kërkesës rritje të fuqisë deri në 100W(ERP) për Radio Vala Rinore dhe për ndryshim të kanalit nga 43 në 65 për Tv Zoom.

### ***Ngritja e kapaciteteve***

Gjatë vitit 2015, DMF ka ndjekur trajnime në Francë, Gjermani e Austri për punën me softuerët ICS Telekom/ICS Manager/Antios programe softuerike të ATDI për planifikim frekuencor digjital dhe për instrumente matëse nga fusha e teknologjisë televizive digjitale; trajnime në kuadër të fillimit të Implementimit të Projektit “Sistemi digjital” - projekt kapital i financuar nga Buxheti i Kosovës, me qëllim për avancimin e pajisjeve softuerike dhe hardverike të KPM-së për planifikim dhe implementim të Sistemit Digjital në Kosovë. Me realizimin e tërësishëm të projektit , po mundësohet të bëhen përgatitjet e duhura rreth procesit të zhvillimit të dialogut për zbatimin e marrëveshjes me Serbinë (për Telekomin në kuadër të së cilës hyn edhe koordinimi i

frekuencave digjitale), me qëllim që të mos ketë interferime në brezin frekuencor nga të dy palët në brezat radio difuzive UHF/VHF/TV , bandet III, IV dhe V.

## DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

### *Buxheti*

Komisioni i Pavarur i Mediave është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2015 janë bërë ndryshime lidhur me Buxhetin fillestar në raport me Buxhetin final.

Për vitin 2015, KPM-së i është ndarë buxhet në fillim të vitit 794,341.50 euro, kurse me rishikim të buxhetit është aprovuar buxheti në vlerë prej 1,265,093.00 euro por njëkohësisht kemi edhe kursime në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në nivelin 16.12 % dhe 11.42% nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime dhe aprovimin e dy projekteve kapitale në vlerë prej 580,265.00 euro (të ndarë para vendimit të Qeverisë me nr. 05/67) me kontrata në vazhdim nga viti 2014.

Me vendim të Qeverisë, në muajin dhjetor 2015, Buxheti final ndryshon pasi që kemi kursime buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike me nr. të Vendimit: nr. 12/64 në kategorinë e pagave dhe mëditjeve; Vendimi nr. 09/65 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve komunale dhe Vendimi nr. 05/67 në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.

Shkurtime buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike kanë vlerën prej 10,931 euro, dhe nga Buxheti i aprovuar pas rishikimit në vlerë prej 1,265,093.00 euro, kemi Buxhetin final në vlerë prej 1,254,162 euro.

Për periudhën Janar dhjetor 2015, Komisioni i Pavarur i Mediave ka shpenzuar buxhetin në vlerë prej 1,252,431 euro apo 100 %.

<b>Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2015</b>				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar



Pagat dhe mëditjet	440,937	362,239	362,239	0.00
Mallra dhe Shërbime	336,405	287,812	286,879	933
Shërbime Komunale	17,000	26,999	26,999	0.00
Gjithsejt Projekt.Kapit.		577,112	576,313	799
Sistemi Digjital		283,112	283,112	0.00
Arkiva Elektronike		294,000	293,201	799
Total:	794,342	1,254,162	1,252,431	1,732

Nga të hyrat vetanake të mbledhura prej taksës së licencës nga shërbimet audio-vizuale janë gjeneruar 309,326 Euro, prej tyre 306,683 euro u takojnë të hyrave nga licenca ndërsa shuma prej 2,643 euro u takojnë të hyrave nga dënimet për vonesën e pagesës së taksës. Mjetet nga të hyrat shkojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, buxheti fillestar në vlerë prej 440,937 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 369,844 euro. Ky zvogëlim bëhet me Rishikim të buxhetit dhe kemi kursimin e shpenzimeve në nivelin 16.12% të shumës së alokuar nga ndarjet Buxhetore nga kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje, me datën 05.08.2015. Po ashtu në muajin Dhjetor 2015, me vendim të Qeverisë me nr.12/64, Buxheti në vlerë prej 369,844 euro është zvogëluar në vlerë prej 362,239 euro që d.m.th. se kemi kursime buxhetore në vlerë prej 7,604.83 euro.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti fillestar në vlerë prej 336,405 euro në krahasim me buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 297,984 euro. Ky zvogëlim bëhet me Rishikim të buxhetit dhe kemi kursimin e shpenzimeve në nivelin 11.42% të shumës së alokuar nga Ndarjet Buxhetore nga kategoria ekonomike Mallra dhe shërbime, me datën 05.08.2015.

Pas Rishikimit të Buxhetit është aprovuar kërkesa për transferin e mjeteve në vlerë prej 10,000 euro nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e komunalive.

Po ashtu në muajin Dhjetor 2015, me vendim të Qeverisë me nr. 09/65 Buxheti në vlerë prej 297,984 është zvogëluar në vlerë prej 287,812 euro që d.th.se kemi kursime buxhetore në vlerë prej 171.77 euro. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 286,879 euro apo 100%.

Po ashtu edhe në kategorinë e komunalive buxheti fillestar në vlerë prej 17,000 euro në krahasim me buxhetin final ka rritje në vlerë prej 27,000 euro. Pas Rishikimit të Buxhetit është aprovuar kërkesa për transferin e mjeteve në vlerë prej 10,000 euro nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e komunalive. Po ashtu në muajin Dhjetor 2015, me vendim të Qeverisë me nr. 09/65, Buxheti në vlerë prej 27,000 euro është zvogëluar në vlerë prej 26,999 euro që d.m.th. se kemi kursime buxhetore në vlerë prej 1.00 euro.

Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e komunalive është 26,999 euro apo 100%.

Në kategorinë e Projekteve kapitale buxheti fillestar në vlerë prej 580,265 euro aprovohet me rishikim të buxhetit. Po ashtu në muajin Dhjetor 2015, me vendim të Qeverisë me nr. 05/67 Buxheti në vlerë prej 580,265 është zvogëluar në vlerë prej 577,112 euro që d.m.th. se kemi kursime buxhetore në vlerë prej 3,153 euro.

Me Rishikim të Buxhetit në kategorinë e Projekteve kapitale janë aprovuar dy Projektet që janë në vazhdim prej vitit 2014. Projektet e aprovuara edhe pas vendimit të Qeverisë me nr. 05/67 janë: 1) Sistemi Digjital me vlerë prej 283,112 euro që është shpenzuar 100% dhe 2) Arkiva Elektronike me vlerë prej 294,000 euro që është shpenzuar 100%. Vlera totale e shpenzuar në kategorinë e Projekteve Kapitale është 576,313 euro apo 100 %.

Gjatë vitit 2015, KPM është ballafaquar me probleme sa i përket buxhetit sidomos pas shkurtimeve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe në kategorinë e komunalive që kanë rezultuar me Rishikim të buxhetit.

KPM gjatë vitit 2015 në mungesë të ndarjeve buxhetore, vazhdimisht ka kërkuar mjete shtesë, për të qenë funksional dhe për të kryer obligimet dhe detyrat që na janë dhënë me ligj, në mënyrë që të mos barten obligimet prej viti në vit.

Në mungesë të mjeteve, vitin 2016 do t`a fillojmë me obligimet kontraktuale të papaguara të vitit 2015 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Obligimet e bartura nga viti paraprak janë në vlerë prej 29,265.75 euro dhe do të mbulohen nga buxheti i aprovuar për vitin 2016.

Problemi tjetër qëndron edhe lidhur me Shërbimet Audio – Vizuale që nuk e kanë kryer obligimin e tyre për pagesën e taksës për licencë për vitet paraprake (borxhet e viteve paraprake 2011,2012, 2013) në vlerë prej 222,753 euro. KPM këto raste i ka proceduar në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjithashtu kemi probleme te Shërbimet audio-vizuale që nuk e kanë kryer obligimin e pagesës së taksës për licencë për periudhën janar-dhjetor 2015, si dhe pagesën e taksës për vitin 2014 që kapin shumën në vlerë prej 174,002 euro. (Në formën tabelore janë të paraqitura në PVF). Edhe pse KPM gjatë mbledhjeve të mbajtura, ka marrë vendime që këtyre të licencuarve t`u jepet edhe një mundësi me shtyrje të afatit deri në dhjetor, si dhe mundësin e pagesës së taksës në dy këste, këta të licencuar kanë dështuar të kryejnë obligimet për pagesën.

Në **Shtojcën III a** është paraqitur Raporti financiar sipas kërkesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe në Shtojcën **III b** është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën e Auditorit Gjeneral.

## **PUNA E BORDIT PËR ANKESA (BA)**

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit të KPM-së. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së.

### ***Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa***

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2015, ka shqyrtuar gjithsej gjashtë (6) ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së.

### ***Rastet të cilat janë shqyrtuar nga ana e Bordit për Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të KPM-së gjatë vitit 2015 janë si në vijim:***

1. Ankesa e operatorit kabllor EGC. Bordi për Ankesa, me datën 27 gusht 2015, ka shqyrtuar ankesën e EGC kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, për shkelje të nenit 2 paragrafi 1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit kabllor EGC, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.
2. Ankesa e operatorit kabllor Kosova Net. Bordi për Ankesa me datën 27 gusht 2015, ka shqyrtuar ankesën e operatorit kabllor Kosova Net kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 5,000.00 (pesëmijë) euro, për shkelje të nenit 2 paragrafit 2.1.3, 2.1.5, dhe nenin 3 paragrafi 3.2.1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit kabllor Kosova Net, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.
3. Ankesa e subjektit transmetues Top Kosova Radio. Bordi për Ankesa me datën 27 gusht 2015, ka shqyrtuar ankesën e subjektit transmetues Top Kosova Radio kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1.000 (njëmijë) euro, për shkelje të nenit 6 paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së subjektit transmetues Top Kosova Radio, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.
4. Ankesa e subjektit transmetues Radio Drenica. Bordi për Ankesa me datën 13 tetor 2015, ka shqyrtuar ankesën e subjektit transmetues Radio Drenica kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1.000 (njëmijë) euro, për shkelje të nenit 6

paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së subjektit transmetues Radio Drenica, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.

5. Ankesa e subjektit transmetues Radio Zëri i Pozharanit. Bordi për Ankesa me datën 13 tetor 2015, ka shqyrtuar ankesën e subjektit transmetues Radio Zëri i Pozharanit kundër gjobës së shqiptuar nga ana e Komisionit të KPM-së në vlerë prej 1.000 (njëmijë) euro, për shkelje të nenit 6 paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas shqyrtimit të ankesës së subjektit transmetues Radio Zëri i Pozharanit, Bordi për Ankesa e vërtetoi vendimin sanksionues të shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.
6. Ankesa e operatorit kabllor IPKO. Bordi për Ankesa me datën 27 gusht 2015, ka shqyrtuar ankesën e operatorit kabllor IPKO kundër Vendim të Komisionit të KPM-së, dhe refuzimit të ankesave si të pabazuara të bëra nga IPKO ndaj operatoreve kabllorë për bartje të platformës TRING TV në territorin Republikës së Kosovës. Bordi për Ankesa pas shqyrtimit të Ankesës së operatorit kabllor IPKO, ka konstatuar se ankesa e palës ankuese është e pa bazuar dhe si e tillë refuzohet, dhe ka vërtetuar Vendimin e Komisionit të KPM-së.

## **OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2015:**

- Implementimi i Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës:

Në kuadër të Implementimit të Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor janë bërë edhe zhvillime në kapacitetet e brendshme të KPM-së. Strategjia për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës, është miratuar nga KPM me 31 mars 2015, në bazë të kërkesës për rishikim nga Qeveria dhe është dërguar për miratim tek Qeveria e Republikës së Kosovës. Deri tani KPM është në pritje të miratimit të Strategjisë së Digjitalizimit nga ana e Qeverisë.

- Krijimi i bazës ligjore sekondare për zbatueshmërinë e Strategjisë:

Strategjia e Dixhitalizimit nuk është miratuar ende deri tani nga ana e Qeverisë dhe për këtë shkak nuk kemi mundur të procedojmë me krijimin e planifikuar të bazës ligjore. Por në kuadër të obligimeve që dalin nga Ligji për Dixhitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive, KPM-ja ka ndërmarrë këto veprime: Miratimi i Planit Frekuencor për Transmetimet Tokësore Digjitale, Krijimi i Komisionit Mbikëqyrës për Tenderin e Multipleksit, kërkesa tek misioni

TAIEX për angazhimin e ekspertëve ndërkombëtar në kuadër të hartimit të bazës ligjore sekondare që del nga Ligji për Digjitalizim dhe në bazë të përgjigjes për këtë kërkesë eksperti pritet të vijë në fillim të 2016.

- Ndërtimi i rrjetit për transmetim televiziv tokësor digjital SFN- allotmenti Kosova: Deri me tani ky objektiv nuk është realizuar, kjo për shkak të mosmiratimit të Strategjisë nga ana e Qeverisë.

## **OBJEKTIVAT E PARAPARA PËR VITIN 2016:**

- Implementimi i Strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor në Republikën e Kosovës
- Implementimi i Ligjit për Dixhitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive
- Amadamentimi i akteve nënligjore ekzistuese dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që dalin si obligimi nga Ligjit për Dixhitalizimin e Transmetimeve Tokësore Radiodifuzive
- Avancimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane
- Zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben gjithë qytetarëve të Kosovës

### ***Rekomandimet/sfidat e institucionit (problemet me buxhetin, rritja e stafit, ndryshimi i ligjit)***

#### ***Problemet me buxhetin***

Shkurtime buxhetore që KPM ka pasur në këto vitet e fundit, na bëjnë që të jemi të kufizuar në funksionimin tonë si një institucion i pavarur dhe rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme.

#### ***Nevoja për punëtorë të rinj***

Për disa vjet radhazi, KPM kërkon shtimin e stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlihen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM është rritur dukshëm dhe se shtimi i volumit të detyrave për nëpunësit ekzistues është trefishuar. KPM-ja ka paraqit kërkesa në vazhdimësi dhe ende nuk është aprovuar kjo rritje e

numrit të punëtorëve. Aktualisht jemi duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë për të kryer detyrat sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësoj edhe punën e KPM-së në e ligjit të KPM-së dhe atij për Digjitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

## PLANI I VEPRIMIT TË MENAXHMENTIT

### Për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it për vitin paraprak

Nr	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1	<b>Rekomandimi nr . 1</b>	KPM-ja ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka bërë ndryshimin e Rregullores për mënyrën e pagesës së taksës për licencë në fund të vitit 2014. Rregullorja e re e KPM-së për mënyrën e pagesës së taksës për licencës rregullon ato mangësi të gjetura në rregulloren e vjetër.	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave
2	<b>Rekomandimi nr. 2</b>	Kriteret kanë mund të jenë më të specifikuar, mirëpo ato kanë qenë për të gjithë ofertuesit njësoj, dhe nuk është bërë e padrejtë asnjë operatori ekonomik, po ashtu kontrata i është dhënë tenderit të përgjegjshëm me çmim më të lirë.	Janë marr masat që në të ardhmen kriteret të përcaktohen ashtu siç është kërkuar nga auditori lidhur me kontratën në fjalë.	Drejtori i Prokurimit
3	<b>Rekomandimi nr. 3</b>	KPM-ja ka ndërmarr veprimet e menjëhershme qysh në vitin 2014 që pranimi i derivateve të bëhet me vendim dhe komision nga tre	Janë marr masat për vitet në vijim.	Komisioni i Pavarur i Mediave

		anëtar.		
4	<b>Rekomandimi nr. 4</b>	<p>KPM-ja ka bërë kërkesë në MAP dhe zyrtarët e KPM-së janë trajnuar me datën 20.04.2015. KPM-ja ka filluar me zbatimin e sistemit E-Pasuria.</p> <p>Sa i përket depos zyrtari i depos ka filluar me aplikimin e kërkesës së hyrje-daljeve të materialit nga depoja për secilin të punësuar të KPM-së .</p>	Janë marr masat për vitet në vijim	Komisioni i Pavarur i Mediave
5	<b>Rekomandimi nr. 5</b>	<p>Për shkak të vonesave nga Gjykata Ekonomike e Kosovës, në lidhje me lëndët e proceduara nga Departamenti Ligjor gjatë viteve të kaluara, të arkëtueshmet janë grumbulluar dhe vlera e tyre është rritur ndër vite. Kjo ka qenë një arsye të rritjes së të arketushmeve.</p>	<p>KPM-ja ka ndërmarr hapat të ri sa i përket kësaj qështje ka fuqizuar mekanizmat e saj në lidhje me mos pagesën e taksës për licencë nga shërbimet audio-vizuale, duke nxjerr Rregulloren - KPM 2014/03 për mënyrën e pagesës së taksës për licencë</p>	Komisioni i Pavarur i Mediave



## **Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it**

**Rekomandimi 1** Kryetari i Komisionit duhet të monitoroj zbatimin e rregullores së re në praktikë për të siguruar respektimin e afatit të rishikuar, më 31 mars, për inkasimin e të hyrave. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime shtesë për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara të viteve paraprake.

**Rekomandimi 2** Kryetari i Komisionit duhet të siguroj se departamenti i prokurimit me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit, çdo kriter duhet ta precizojë qartë për të konfirmuar ofrimin e shërbimit të një standardi të duhur.

**Rekomandimi 3** Kryetari i Komisionit duhet të siguroj që në rastet kur ekziston rreziku që malli që ofrohet mund të mos jetë në sasinë dhe cilësinë e duhur të formojë komisione të pranimit për të shtuar masat e kontrollit.

**Rekomandimi 4** Kryetari i Komisionit duhet të ndërmerr veprime konkrete me qëllim që të siguroj fillimin e përdorimit të sistemit “e-Pasuria”, në mënyrë që të shfrytëzohen shërbimet e këtij sistemi. Fillimisht duhet kërkuar nga MAP-i si kontraktor i këtij sistemi të siguroj trajnime për stafin për aplikimin e këtij sistemi. Me funksionalizimin e këtij sistemi mundësohet edhe menaxhimi i depozitave dhe evitohen mangësitë aktuale.

**Rekomandimi 5** Kryetari i Komisionit duhet të rishikojë me vendosmëri se janë marrë të gjitha masat në pajtim me rregulloren dhe ligjin e KPM-së, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet. Në këtë aspekt duhet shqyrtuar mundësinë e revokimit të licencës dhe të konfiskimit të pajisjeve.